

URDHËR
Nr. 136, datë 6.8.2024

**PËR CAKTIMIN E NËNPREFEKTIT MALLAKASTËR, ZNJ. MBARIME ISUFAJ,
PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE DETYRAVE TË PREFEKTIT TË
QARKUT FIER**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 1/1, të nenit 22, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Caktimin e nënprefektit të Mallakastrës, znj. Mbarime Isufaj, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të prefektit të qarkut Fier.
2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e prefektit të qarkut Fier ose deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet nënprefekti i Mallakastrës, znj. Mbarime Isufaj dhe institucioni i prefektit të qarkut Fier.

Urdhri nr. 66, me nr. prot. 3886, me lëndë: “Për delegim të kompetencave”, datë 4.4.2024, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Ervin Hoxha